



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Prokurimit - Komuna Junik

Datë: 27.04.2020

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, paragrafi 6 dhe 10, pika 10.1 dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 16.04.2020, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim (ankesës) të parashtruar nga Operatori Ekonomik, "Joos&Krasniqi - Bazë", Sh.p.k nga Juniku, të datës: 22.04.2020, lidhur me tenderin "Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë", me numër të brendshëm të prokurimit: 636-19-022-511 dhe me numër të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1, të shpallur me dt. 17.07.2019, Zyra e Prokurimit mori këtë:

VENDIM

- I. Refuzohet** si e pabazë kërkesa për ri-shqyrtim (ankesa) e OE, "Joos&Krasniqi - Bazë" sh.p.k nga Juniku, e parashtruar me datën: 22.04.2020, lidhur me tenderin: "Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë", me numër të brendshëm të prokurimit: 636-19-022-511 dhe me numër të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1.
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna Junik i datës 16.04.2020.**
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas ditës së nënshkrimit të këtij vendimi.**

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Komuna Junik, shqyrtoi kërkesën për ri-shqyrtim të datës: 21.04.2020, të pranuar përmes sistemit elektronik E-Prokurimi e parashtruar nga "Joos&Krasniqi - Bazë" sh.p.k me seli në Junik, duke analizuar të gjitha faktet e ofruara nga operatori ekonomik në fjalë dhe bazuar në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar për këto arsye:

Autoriteti Kontraktues, Komuna Junik, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar në web faqen zyrtare të E-Prokurimit.

Provë: Njoftimi i Publikuar në web faqen zyrtare të E- Prokurimit.

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe njoftimit përmes Letrave Standarde lidhur me ri-vlerësimin e lëndës me titull: "Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë", OE "Joos&Krasniqi - Bazë" sh.p.k., ka bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me datën: 21.04.2020, dhe po të njëjtën ditë përfaqësuesit të kompanisë ankuese ju ka lejuar qasja ku edhe ka marrë raportin e ri-vlerësimit të lëndës në fjalë. Me dt: 22.04.2020, OE "Joos&Krasniqi - Bazë" sh.p.k., ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim dhe menjëherë kemi pezulluar aktivitetin e prokurimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
OZ/Nr. Prot.	01-180-2377
Nr. i faq.	4
Data	27/04/2020

Provë: Njoftim për pezullim

Në vazhdim ashtu siç parashihet në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Autoriteti Kontraktues Komuna Junik jep përgjigjeje me shkrim parashtruesit të ankesës, OE “ Joos & Krasniqi - Bazë ” sh.p.k, lidhur me pretendimet e bëra të ankesës në fjalë:

Pas vendimit nr. 100/111/20 nga Paneli Shqyrtues i emëruar nga Kryetari i OSHP- së, që aktiviteti i prokurimit me titull: Ndërtimi rrugës Junik- Gjeravicë të ri-vlerësohet, Autoriteti Kontraktues e respektoi vendimin e OSHP- së dhe e formoi komisionin e ri për ri-vlerësimin e lëndës me titull: Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë.

Provë: Vendimi i OSHP 100/111/20 Njoftim mbi vendimin e AK

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, OE “ Joos&Krasniqi - Bazë ” Sh.p.k., ka bërë kërkesë për qasje në raportin e ri-vlerësimit, qasja ju është lejuar sipas ligjit.

- Në lidhje me shkeljen e nenit 1. Qëllimi, nenit 7, Barazia në trajtim - Jo - diskriminimi, nenit 24. Zyrtarët e Prokurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të Prokurimit, neni 51. Njoftim i Kriteve të Përzgjedhjes, neni 56, Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, neni 60. Kriteret për Dhënien e Kontratës, neni 68. Gjendja Ekonomike dhe Financiare, neni 69. Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, neni 72. Dokumentacioni dhe informacione shtesë si dhe neni 80. Përbërja dhe Vendimet e Jurisë, Autoriteti Kontraktues - Komuna Junik, prej fillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe deri me përmbylljen e aktivitetit, me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Anulimin e aktivitetit të prokurimit e ka zbatuar Ligjin e Prokurimit Publik në fuqi për zhvillimin e procedurës, duke vepruar në mënyrë transparente dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik.

-Në lidhje me shkeljen e nenit 1, të Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi si dhe vendimin e OSHP- së siç pretendon operatori ekonomik ankues, Autoriteti Kontraktues Komuna Junik, përkundrazi e ka përfillur dhe e ka vlerësuar lartë vendimin e OSHP- së për kthimin e lëndës në ri-vlerësim sepse pas ri-vlerësimit ka konstatuar se asnjë ofertë nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, e në këtë rast ka sjellur vendimin me të arsyeshëm duke e ruajtur kështu buxhetin dhe fondet tjera publike.

-Në lidhje me shkeljen e nenit 7, 24 dhe nenit 51 siç pretendon operatori ekonomik ankues nuk qëndrojnë pretendimet e tilla sepse Zyrtarët e Prokurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të Prokurimit kanë vepruar në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomik si dhe me transparencë të plotë ndaj tyre për të gjithë aktivitetin e prokurimit duke respektuar gjithnjë kriteret e përzgjedhjes të paraqitura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

-Në lidhje me shkeljet e nenit 56, nenit 59 dhe nenit 60 të Ligjit të Prokurimit në fuqi siç pretendon operatori ekonomik ankues, nuk qëndrojnë si pretendime sepse Autoriteti Kontraktues Komuna Junik përkatësisht Zyra e Prokurimit ka vepruar konform këtyre neneve duke i ri-vlerësuar me përpikëmeri të gjitha kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe pas ri-vlerësimit të ofertave ka rezultuar se asnjë ofertë e pranuar nuk është e përgjegjshme me çmimin më të lirë siç e kërkon neni 60 i Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi.

-Në lidhje me shkeljen e nenit 68. Gjendja Ekonomike dhe Financiare, pas ri-vlerësimit të ofertave është konstatuar se nuk e plotësoni pikën III.2.3, kërkesën me numër 3, siç kërkohet nga

Autoriteti Kontraktues, ku tek kjo pikë si dëshmi, dokumenti i dorëzuar nga ana juaj duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga institucioni bankar që dëshmon se OE ka mjete të mjaftueshme financiare të gatshme (vlera sipas kërkesës së AK), ndërsa ju si operatorë ekonomik keni ofruar një dokument nga institucioni bankar që se përmbush kërkesën e Autoritetit Kontraktues, sepse dokumenti i tillë nuk dëshmon se ju keni para të gatshme në bankë në vlerën e cekur sipas kërkesës së AK, mirë ky dokument dëshmon se në rast se fitoni projektin, institucioni bankar do të i'u përkrah vetëm nëse i plotësoni kushtet e vendosuar nga institucioni bankar.

-Në lidhje me shkeljen e nenit 69 të Ligjit të Prokurimit në fuqi siç pretendon operatori ekonomik ankues, pas ri-vlerësimit të ofertave është konstatuar se nuk e plotësoni pikën III.2.4- Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkesën me numër 9 dhe kërkesën me numër 10 të kapacitetit teknik dhe profesional, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, pasi që dëshmia e ofruar nga ana juaj nuk është në harmoni me kërkesën e Autoritetit Kontraktues ku kërkesa me numër 9 është: ***“Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi nga Banka Listat e pagave që dëshmojnë se janë kryer obligimet ndaj stafit dhe punëtorëve”***, ndërsa si dëshmi për kërkesën me numër 9 kemi kërkuar: ***“Nga Banka (Lista e pagave) të Operatorit ekonomik që dëshmon se ka kryer obligimet ndaj punëtorëve (minimum 50 punëtorë) për 6 muajt e fundit e nënshkruar dhe vulosur nga banka. Këtë kërkesë nuk e keni plotësuar siç kërkohet në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit sepse lista e pagave të punëtorëve është e vulosur vetëm nga një institucion bankar dhe jo nga të gjitha institucionet bankare në të cilat i marini pagat punëtorët tuaj. Ne, nuk e hedhim poshtë se ju keni plotësuar kërkesën me numër 2, të kapacitetit teknik dhe profesional ku kërkesa është: “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku nga 50 (pesëdhjetë) punëtorë në listën e punëtorëve të paraqitur në ATK për secilin vit, ne tri vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontratë”***, ndërsa si dëshmi për kërkesën me numër 2 kemi kërkuar: ***“Nga ATK-ja për pagesen e kontributeve se paku 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (e noterizuar)”***, mirëpo vlerësojmë bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik dhe kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, ku sipas Ligjit të Prokurimit Publik, një ofertë konsiderohet e përgjegjshme vetëm në rast se i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Ndërsa kërkesën me numër 10 nuk e plotësoni sipas kriterit të Autoritetit Kontraktues sepse ju mungon makineria e rënde kryesore për realizimin e këtij projekti Buldozer D7. Në listën e ofruar nga ana juaj për makinerinë keni deklaruar se i posedoni 3 Buldozera D7, ndërsa ju nuk e keni ofruar asnjë dëshmi sipas kërkesës së AK, po ashtu te kjo pikë keni ngarkuar në sistemin dokumente lidhur me makinerinë të cilat janë tërësisht të paidentifikueshme për vlerësimin e tyre (Te Makineritë 1, fq. 25, 26 dhe 31. Makineritë 2, fq 28, Makineritë 3, fq 18, të Makineritë 4 fq 2). Gjithashtu keni ngarkuar dokumente të panevojshme dhe të pa kërkuara nga Autoriteti Kontraktues gjë që është përtej asaj që kërkohet në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

-Në kërkesën e juaj për rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit nuk është cekur nga ana juaj, mirëpo arsye tjetër e eliminimit tuaj nga ky aktivitet i prokurimit është sepse nuk e keni plotësuar kërkesën me numër 13. Të kapacitetit teknik dhe profesional ku nga Autoriteti Kontraktues kërkohet: ***“Operatori Ekonomik ofertues (në rast të konsorciumit-Lideri i konsorciumit) duhet të dëshmojë se ka kryer vlerësimin e riskut për të gjitha pozitat për konform ligjit 04 L-161”***, si dëshmi për kërkesën numër 13 kemi kërkuar: ***“Të dëshmohet me vërtetim nga një kompani e licencuar nga MPMS, se ka kryer vlerësimin e riskut për të gjitha pozitat konform ligjit 04 L-161. (Vërtetimi duhet të jetë i noterizuar)”***, nërsa ju si ofertues keni ofruar dëshmi vetëm për pesë punëtorë që kjo bie në kundërshtim me kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe është kriter i pa plotësuar sipas kriterit të vendosur nga AK në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Duke u bazuar në nenin 39 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale (Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - neni 68 i Ligjit të Prokurimit Publik), Autoriteti Kontraktues nuk i ka shkel në asnjë mënyrë nenet 72 dhe 80 të Ligjit të Prokurimit Publik sepse bazuar në këtë paragraf nuk mund të kërkojmë informata sqaruese sipas nenit 72 të Ligjit për kriteret që nëse nuk janë përmbush nga operatori ekonomik sipas kërkesave të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, oferta e tij duhet të refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Në asnjë mënyrë Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkel nenin 80 të Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi sepse te ky projekt nuk kemi të bëjme me procedurën e Konkursit të Projektimit siç keni pretenduar ju me anë të ankesës tuaj mirëpo kjo procedurë është procedurë e hapur me vlerë të madhe që formimi i komisionit bëhet duke u bazuar në nenin 59, paragrafi 1 i Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi dhe nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, dhe ju sqarojmë se formimi i komisionit për ri- vlerësimin e ofertave është në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Autoriteti Kontraktues - Komuna Junik në asnjë rrethanë nuk i ka shkelur Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit - Panelit Shqyrtues por në të gjitha rastet i ka respektuar Vendimet e tilla dhe lëndën e ka kthyer në ri - vlerësim.

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroi ankesë konform Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 109 pika 2 në OSHP.

U.D.Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit:



Aktvendimi ti dorëzohet:

- Zyrës së Prokurimi
- OE: Ankuesit - “ Joos&Krasniqi – Bazë ”, Sh.p.k
- Arkivit të Komunës